

VENDIM
Nr. 402, datë 3.5.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1108, DATË 30.12.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR TRANSFERIMIN, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TE BASHKITË, TË
INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, TË PERSONELIT DHE TË
ASETEVE TË LUAJTSHME E TË PALUAJTSHME TË BORDEVE RAJONALE TË
KULLIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 3, shkronja “dh”, e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tabelën 2, “Tabela e Aseteve të Qëndrueshme”, bashkëlidhur vendimit nr. 1108, datë 30.12.2015, të Këshillit të Ministrave, të hiqet nënndarja, si vijon:

Bordi i Kullimit Tiranë	Bashkia Tiranë	1 – Zyra	6587	212
		2 – Ambjente të tjera		1095

2. Asetet e qëndrueshme të Bordit të Kullimit, Tiranë, që përmenden në pikën 1, të këtij vendimi, mbeten në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministri i Shtetit për Çështjet Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi